DALJE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-103p/5
Data Datum Date 04.10.2019

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Srdjan Popoviq**, Kryetar i Komunës së Graqanicës<br>**Lubisa Karadzic**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Graqanicës | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Adrijana Hodžić**, Ministre e MAPL-së<br>**Rozafa Ukimeraj**, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | **Besim Myrtezani** U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 01/10/2019<br>Nr.020-1039 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br><br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>**Kujtim Aliu**, Zyrtar për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Graqanicës | |
| Lloji i aktit: | Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi me nr. 7209/19 për fillimin e procedurës së shpronësimit të tokës për zgjerimin e varrezave në Gushtericën e Epërme |
| I miratuar më datë: 27.09.2019 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 01.10.2019 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **<u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracija
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-1038/5
Data Datum Date 04.12.2019

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | Srdjan Popović, gradonačelnik opštine Gračanica<br>Ljubiša Karadžić, predsedavjući Skupštine opštine Gračanica | |
| Cc: | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u<br>Jedinici za administarciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | Adrijana Hodžić, ministarka MALS-a<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a, | |
| Od: | Besim Myrtezani, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština /MALS | Datum, 01.10.2019.<br>Br. 020-1039 |
| | | |
| Službenik za potvrđivanje pravne procene:<br><br>Službenik za izradu: | Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština<br><br>Kujtim Aliu, službenik za monitorisanje opština | |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Gračanica | |
| Vrsta odluke: | Odluka Skupštine opštine | |

Uvaženi gradonačelniče,
Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-05 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka sa br. 7209/19 za pokretanje procedure eksporpijacije zemljišta za proširivanje groblja u Donjoj Gušterici |
| Usvojena dana, 27.09.2019. godine, |
| Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 01.10.2019. godine, |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta

opštine, procenjuje da je **opštinski akt iz proceduralnog aspekta u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvesti pravni efekat.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA
7209/19 01-10-2019

ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d), nenit 17 paragrafi 1 pika f) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 4 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.4.3.5, nenit 7 paragrafi 2 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme nr.03/L-139 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.52/2009), nenit 8 paragrafi 1 pika gj), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e shtatë të rregullt, e mbajtur më datën 27.09.2019, merr këtë:

**V E N D I M Nr.59/2019/KG**

**për fillimin e procedurës së shpronësimin e tokës për zgjerimin e varrezave në Gushtericën e Epërme**

**Neni 1**

Miratohet Vendimi për fillimin e procedurës së shpronësimin e tokës për zgjerimin e varrezave në Gushtericën e Epërme.

**Neni 2**

Për qëllim të zgjerimit të varrezave ekzistuese në Gushtericën e Epërme është e nevojshme të shpronësohen 1000 m² (10 ari) nga parcela nr.700/2 ZK Gushterica e Epërme, arë e klasës së 3-të, në pronësi të Dragan Qirkoviqit (***Dragan Ćirković***), sipërfaqja e përgjithshme e të cilës është 2300 m² (23 ari).

**Neni 3**

Shpronësimi i një pjese të parcelës në fjalë është i domosdoshëm për zgjerimin e varrezave ekzistuese në Gushtericën e Epërme, me çka realizohet interesi publik, i cili është i nevojshëm për procedurën e shpronësimit të pronës së paluajtshme.

**Neni 4**

Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të vendimit, në përputhje me Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme nr.03/L-139.

**Neni 5**

Për zbatimin e këtij vendimi janë përgjegjëse drejtoritë komunale.

**Neni 6**

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të tij në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Graçanicës.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ljubisa Karadžić**